

AKT THEMELIMI

SHOQERISE "MUZHAQI" SH.P.K.

Ne Librazhd sot me dt. 08. 04. 2002, ne nenshkruesit

1-Halit MUZHAQI

2-Fatmir POLISI

me deshiren dhe vullnetin tone te plote, ne mbeshtetje te nenit 2 te ligjit 7512 date 10.08.1991 dhe ne zbatim te ligjit 7638 date 19.11.1992, ligjit Nr.7667 dt.28.1.1993, vendosem te bejme themelimin e shoqerise "MUZHAQI" SH.P.K. si me poshte :

NENI 1

Te krijohet shoqeria private e ndertimit "MUZHAQI".

NENI 2

Themeluesit me cilesine e ortakeve te shoqerise "MUZHAQI" SH.P.K. jane ne pjese te barabarta kapitali, Halit Muzhaqi e Fatmir Polisi, me qender ne Librazhd.

NENI 3

Shoqeria gezon statusin e personit juridik si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj do te funksionoje dhe rregullohet konforme akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi si dhe te ketij Akt-Themelim dhe te statutit te kesaj shoqerie.

NENI 4

Afati i veprimtarise se Shoqerise caktohet mbi 10 vjet, me perjashtim te rasteve kur ortaket vendosin per prishje te parakoheshme ose kur ekzistojne rrethanat per shtyrje te metejshme.

NENI 5

Objekti i veprimtarise.

- Punime dheu, sistemim, tarracime terrenesh etj.
- Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj, instalimet e nevojshme per to.
- Ndertime rrugeshe te kategorise V-I si dhe asfaltimin e tyre.
- Ndertime te veprave te artit rrugore dhe hekurudhore.
- Punime dhe ndertim ne sistemin hidraulik.
- Kqyrjen e instalimeve elektrike, hidraulike, metalike etj.
- Prodhim, perpunim, transportim i materialeve te ndryshme per ndertim.
- Import-eksport te mallrave te ndryshem industriale.

NENI 6

Me vendim te themeluesve te saj, shoqeria munde te ndryshoje emrin, seline, formen juridike, objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve ne statut dhe ne aktin e themelimit.

NENI 7

Kapitali themeltare i shoqerise eshte ne leke ne shumen 100.000 ne kuota te barabarta 50.000 per sejcilin, e shprehur ne % kjo eshte 50 % i çdo ortaku. Shoqeria do te kete numer llogarie bankare ne Librazhd.

NENI 8

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saje, administrative, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkangjitur.
Shoqeria do te drejtohet nga administratori Halit Muzhaqi.


NENI 9

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve, emerimi, shkarkimi i tyre behet nga asambleja e ortakeve.
Mardheniet e punes do te bazohen ne kontraten e punes te bazuara ne legjislacionin ne fuqi.

NENI 10

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkangjitet ketij Akt-themelimi.

THEMELUESIT E SHOQERISE "MUZHAQI" SH.P.K.

Halit Muzhaqi


Fatmir Ralisi
